

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trump hedh poshtë propozimin iranian për të hapur Hormuzin dhe për t'i dhënë fund luftimeve: Po humb asin shumë keq - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/trump-hedh-poshte-propozimin-iranian-per-te-hapur-hormuzin-dhe-per-t-i-dhene-fund-luftimeve-po-humbasin-shume-keq/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 15:30:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 15:27:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5a455817b753fe04559dc3ada85204fdfa6735b73c18325e42caad25c4a10d36
TEKSTI	b304d95aa7ea501026996cf3deb7bd7c7b389c544a9e8ecf4652353e4e8a0e48
PAMJA	d57eb574f8145eb9ccdc05741e851cec5e76c7317fb48d445e02b447752f21ee

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	207e29b21bf839898a6aa6898ffe75a8e55a08dbd2b1b67e14929920792cf4d4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0334a22cab892da6eda5613cc640e69aa8a23a21585bae5896651df887e79535
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/207e29b21bf839898a6aa6898ffe75a8e55a08dbd2b1b67e14929920792cf4d4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Eric Wendt Donald Trump Durrës Lufta në Ukrainë

BOTA | LAJM KRYESOR

Trump hedh poshtë propozimin iranian për të hapur Hormuzin dhe për t'i dhënë fund luftimeve: Po humbasin shumë keq

26 Shtator 2026 | 17:27

Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, tha të shtunën se kishte hedhur poshtë një propozim iranian për të rihapur Ngushticën e Hormuzit dhe për t'i dhënë fund luftimeve në Lindjen e Mesme.

Irani e ngriti iniciativën në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork, duke thënë se ajo u ishte transmetuar amerikanëve nëpërmjet ndërmjetësve të Katarit dhe se mund të rihapte rrugën ujore strategjike dhe t'i jepte fund armiqësive në rajon brenda shtatë ditësh.

Por në komentet për gazetarët në Shtëpinë e Bardhë, Trump tha: "Unë e refuzoj propozimin e tyre. Unë e refuzova marrëveshjen e tyre. Ata duan të bëjnë një marrëveshje për të hapur menjëherë Ngushticën e Hormuzit sepse po humbasin shumë keq", tha ai para se të nisej për në Tenesi.

"Po fitojmë jashtëzakonisht shumë. Ata duan të bëjnë një marrëveshje dhe mendoj se kjo është në rregull, edhe mua më pëlqen të bëj një marrëveshje. Ajo që duan të bëjnë është të hapin menjëherë Ngushticën e Hormuzit, sepse nuk kanë para që hyjnë, sepse i marrin paratë e tyre nga Ngushtica e Hormuzit", tha Trump.

SHBA-të kanë vendosur një bllokadë ekonomike ndaj Iranit për të ushtruar presion mbi Teheranin që të heqë bllokadën e Hormuzit, e cila ka zvogëluar në mënyrë drastike transportin detar përmes ngushticës, edhe pse Trump përsëri deklaroi se SHBA-të kishin kontrollin e rrugës ujore.

Wall Street Journal raportoi për herë të parë se Trump e kishte hedhur poshtë propozimin iranian, duke cituar zyrtarë të paidentifikuar amerikanë.

Thuhej se Trump ishte skeptik se Irani do t'i përmbushte kërkesat e tij dhe i kishte thënë stafit të tij se e shih të mundshme një fushatë të ripërtërirë bombardimesh pas zgjedhjeve të nëntorit për Kongresin në SHBA.

Një zyrtar amerikan kishte thënë më parë se diskutimet me Iranin përmes ndërmjetësve ishin "pozitive dhe konstruktive".

LAJMI I FUNDIT

17:18 Reagimi i fortë i Erdoganit: Kriminelët e luftës i përkasin gjykatave, jo podiumit të OKB-së

17:03 Irlanda konfirmon zhvillimin e ndeshjes me Izraelin pas votimit të lojtarëve

16:48 PD letrë zyrtare Peleshit: Zbatoni vendimin e Kushtetueses për Komisionin Hetimor të zgjedhjeve të 11 majit

16:41 Kina kundërshton SHBA-në për SHPËRNDARJE Iranin dhe Kubën në fjalimin e saj në OKB
ARTIKULLIN

16:36 Telefoni në moshën 12 vjeçare, shkak për çrregullime e të ngrënit

16:33 Nis epoka "Maran", trajneri surprizon me formacionin për sfidën ndaj Bjellorusisë

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA
Reagimi i fortë i Erdoganit: Kriminelët e luftës i përkasin gjykatave, jo podiumit të OKB-së
Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, ka reaguar ashpër për fjalimet e mbajtura në Asamblenë e OKB-së, duke mos e cituar drejtpërdrejt kryeministrin izraelit, Benjamin...
17:18 | 26/09/2026

BOTA
Kina kundërshton SHBA-në për Iranin dhe Kubën në fjalimin e saj në OKB
Kina kundërshtoi Shtetet e Bashkuara në fjalimin e saj në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së të shtunën, duke thënë se sovraniteti i vendeve në Gjirin...
16:41 | 26/09/2026

BOTA
Telefoni në moshën 12 vjeçare, shkak për çrregullime e të ngrënit
Fëmijët që kanë telefon që në moshën 12-vjeçare mund të kenë më shumë gjasa të shfaqin simptoma të çrregullimeve e të ngrënit, krahasuar me bashkëmoshatarët...
16:36 | 26/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontaktoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026